

Nje det me oferta te pret...

zbulo me teper ne booking.adriaferries.com



Kërko

☒ Të gjitha fjalët
 ☐ Të paktën një fjalë
 ☐ Fjalët ekzakt

Flash

Aksident i rëndë në aksi Milot-Rrëshen, ndërrojnë jetë 3 persona, ende nuk dihen detajet

POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



1 Horror në fshat/ Ndjek me sëpatë komshinjtë, masakron lopët



2 Aksident i rëndë në Rugën e Kombit, dyshohet për 3 viktime dhe disa të plagosur



3 Atentat si në filma/ Momenti kur 2 personat qëllojnë 45-vjeçarin në qendër të Milotit (VIDEO)



Aktualitet

Kokainë, armë zjarri e municion luftarak, pranga tre të rinjve në Shkodër (EMRAT)

Tre të rinj kanë rënë në prangat e policisë pasi u ndaluan duke udhëtuar me 3 armë zjarri pistoletë, një sasi fishekësh dhe një krehër në një makinë tip "Volkswagen". Në pranga kanë rënë Melson Shaqiri, Eraldo Muça dhe Ervin Vukatana.

☐ Operacion anti-drogë në Tiranë, kapet 43-vjeçari me kokainë në makinë te 'Varri i Bamit'

RAPORTO! Chat live
me Shqiptarja.com





Armët e sekuestruara në Shkodër



Redaksia

8 Dhjetor 2019, 10:15 | Përditesimi i fundit: 8 Dhjetor 2019, 14:20

Share 48

Tweet



A A

Nje det me oferta te pret...

zbulo me teper ne booking.adriaferries.com



SHKODER- Tre të rinj kanë rënë në prangat e policisë pasi u ndaluan duke udhëtuar me 3 armë zjarri pistoletë, një sasi fishekësh dhe një krehër në një makinë tip "Volkswagen". Në pranga kanë rënë Melson Shaqiri, Eraldo Muça dhe Ervin Vukatana.


Gjatë kontrollit atij iu gjetën një peshore të vogël elektronike, një qese me një masë kristallore e dyshuar si lëndë narkotike kokainë, dy pilula të dyshuara ekstazi dhe një sasi e dyshuar si lëndë narkotike kanabis.

RAPORTO! Chat live
me Shqiptarja.com



LEXO EDHE:





Shkodër/ Qëlloi me armë drejt një banese, në pranga një 33-vjeçar (VIDEO)



Njoftimi i plote

Finalizohet operacioni policor i koduar "Buna". Sekuestrohen 3 armë zjarri, municion luftarak dhe lëndë narkotike kokainë e kanabis.

Vihen në pranga tre shtetas që posedonin armët e zjarrit dhe lëndën narkotike, si dhe një tjetër procedohet në gjendje të lirë.

Në zbatim të planit të masave për shtimin e kontroleve me qëllim parandalimin, evidentimin dhe goditjen e personave që shpërndajnë lëndë narkotike apo që mbajnë e qarkullojnë me armë zjarri, si dhe për kapjen e personave në kërkim, nga strukturat e Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër, u godit një rast i mbajtjes pa leje të armëve të zjarrit dhe i lëndëve narkotike.

Forca e Posaçme "Shqiponja" në bashkëpunim me Specialisët për hetimin e Narkotikëve në DVP Shkodër dhe Patrullën e Përgjithshme të Komisariatit të Policisë Shkodër në bazë të informacioneve të marra në rrugë operative, se disa të rinj dispononin lëndë narkotike, si dhe në banesa mund të kishin edhe armë zjarri, kanë organizuar dhe finalizuar operacionin policor të koduar "Buna".

Në kuadër të këtij operacioni u bë arrestimi në flagrancë i shtetasve:

- M. Sh., 22 vjeç, banues në Shkodër;
- E. M., 21 vjeç, banues në Shkodër;
- E. V., 31 vjeç, banues në Shkodër.

Si dhe u procedua në gjendje të lirë shtetasi: B. Q., 23 vjeç banues në Shkodër.

Në vendin e quajtur "Ura e Vjetër" e Bunës, Forcat e Posaçme "Shqiponja", kanë bërë bllokimin e mjetit tip "Volksëagen", më të cilin udhëtonin këta shtetas dhe gjatë kontrollit fizik të tyre, policia gjeti në xhepin e xhupit të shtetasit M. Sh., një peshore të vogël elektronike, një qese me një masë kristalore e dyshuar si lëndë narkotike kokainë, dy pilula të dyshuara ekstazi dhe një sasi e dyshuar si lëndë narkotike kanabis, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

Operacioni vijoi me kontrollin e banesave të këtyre shtetasve, ku u sekuestruan edhe banesa e shtetasit E. V., shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan 3 armë zjarri pistoletë, një sasi fishekësh dhe një

RAPORTO! Chat live
me Shqiptarja.com

